

V E N D I M
Nr.413, datë 22.8.1994

**PËR SHPALLJEN E LAGUNËS SË KARAVASTASË DHE PARKUT TË DIVJAKËS SI
EKOSISTEM NATYROR VEÇANËRISHT I MBROJTUR PËR T'U PËRFSHIRË NË
LISTËN E KONVENTËS SË RAMSARIT**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Zona ekologjike Pisha e Divjakës-Laguna e Karavastasë të shpallen zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur për t'u përfshirë në listën e Konventës së Ramsarit.

2. Zona e mbrojtur do të përfshijë sipërfaqen e Parkut Kombëtar (Pisha e Divjakës) prej 1162 ha, zonën e Kularit prej 815 ha dhe sipërfaqen lagunore prej 3967 ha.

Kufijtë e këtij ekosistemi do të jenë:

Veriu - Lumi i Shkumbinit

Lindja - "Vija kufizuese bregdetare" e miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendim nr.321, datë 20.7.1992.

Jugu - "Vija kufizuese bregdetare" e miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendim nr.321, datë 20.7.1992 dhe lumi Seman deri në grykëderdhjen e tij në detin Adriatik.

Perëndimi - Deti Adriatik

3. Pjesa perëndimore e Zonës së Kularit, në veri të këtij ekosistemi, të shpallet Rezervat Gjuetie i kategorisë së katërt sipas klasifikimit të IUCN (Fondi Botëror për Ruajtjen e Natyrës).

Kufijtë e zonës së Kularit do të jenë:

Veriu - Lumi i Shkumbinit

Lindja - "Vija kufizuese bregdetare" e miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.321, datë 20.7.1992.

Jugu - Parku Kombëtar (Emisari i Tërbufit)

Perëndimi - Fusha e Shellirës së Madhe

4. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Turizmit si dhe Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit të përcaktojnë kufijtë e shtrirjes së plazhit të Divjakës dhe të trajtojnë me projekte të veçanta problemet urbanistike dhe turistikë me qëllim ruajtjen e vlerave natyrore të ekosistemit.

5. Aktiviteti i peshkimit në Lagunën e Karavastasë të kryhet sipas sistemit tradicional.

6. Ruajtja dhe administrimi i këtij ekosistemi të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave.

Në organikën e kësaj drejtorie shtohen 5 inspektorë pyjor. Drjtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave për 4-mujorin e tretë të vitit 1994 i shtohen 125.000 lekë që përballohen nga buxheti total i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit për vitin 1994.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi